



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 46, datë 01/10/2004

**“MBI
NJË SHITESË FONDI DHE PERSONELI
NË ORGANIKËN E ADMINISTRATËS SË BIBLIOTEKAVE”**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, i mbledhur sot më datë 01/10/2004, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Kulturës, Rinise dhe Sporteve, në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32, gërma “ç”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.16, dt.10/03/2004 “Për miratimin e realizimit të buxhetit të vitit 2003 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2005”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.726, dt.21/12/2000 “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.297, dt.27/06/2002, ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.656, dt.25/09/2003, indeksuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.184, dt.10/04/2004,

V E N D O S I;

1. Të miratojë një shtesë prej 2 punonjësish në strukturën e Administratës së Bibliotekave.
2. Pagesa e punonjësve do të bëhet sipas lidhjes Nr.1 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Efektet financiare për vitin 2004 do të përballohen duke pakësuar fondin rezervë të të ardhurave në shumën 421.400 lekë, si dhe duke shtuar buxhetin e Administratës së Bibliotekave në shumën totale prej 421.400 lekë, nga të cilat artikulli 600 (paga) në shumën 139.000 lekë, artikulli 601 (sigurime shoqërore) në shumën 40.000 lekë si dhe artikulli 602 (shpenzime operative) në shumën 259.200 lekë.

4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Administrata e Bibliotekave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI